



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri:171

Tiranë – E Hënë, 10 Nëntor 2014

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 137/2014 datë 16.10.2014	Për miratimin e buxhetit faktik për vitin 2013	8595
Ligj nr. 138/2014 datë 16.10.2014	Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë.....	8595
Ligj nr. 139/2014 datë 16.10.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”.....	8602
Ligj nr. 140/2014 datë 16.10.2014	Për ratifikimin e ndryshimit të letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Agrikuturës për Programin “Malet drejt tregut”	8603
Vendim i Kuvendit nr. 83/2014, datë 30.10.2014	Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së dy anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	8605
Vendim i Kuvendit nr. 84/2014, datë 30.10.2014	Për emërimin e zotit Eduard Ypi anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.....	8605
Vendim i Kuvendit nr. 85/2014, datë 30.10.2014	Për zgjedhjen e zonjës Pranvera Strakosha Komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.....	8606
Vendim i Kuvendit nr. 86/2014, datë 30.10.2014	Për zgjedhjen e zonjës Albana Shtylla anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	8606
Vendim i Kuvendit nr. 87/2014, datë 30.10.2014	Për zgjedhjen e zotit Vangjel Kosta anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	8606
Vendim i Kuvendit nr. 88/2014, datë 30.10.2014	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Elona Stavri (Toro) anëtare e Gjykatës së Lartë.....	8606
Vendim i Kuvendit nr. 89/2014, datë 30.10.2014	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Sokol Ngresi anëtar i Gjykatës së Lartë.....	8607

Vendim i Kuvendit nr. 91/2014, datë 30.10.2014	Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislationit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar më thellë fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore.....	8607
Vendim i Kuvendit nr. 92/2014, datë 30.10.2014	Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore.....	8607
Vendim i Kuvendit nr. 94/2014, datë 6.11.2014	Për zgjedhjen e Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	8608
Dekret nr. 8766, datë 31.10.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8608
Dekret nr. 8768, datë 31.10.2014	Për caktimin e përkohshëm të kandidatëve për magjistratë, për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë.....	8608
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 86, datë 29.9.2014	Për fillimin e procedurave të licensimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	8609
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 87, datë 29.9.2014	Për fillimin e procedurave të licensimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	8610
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 88, datë 29.9.2014	Për fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “UKKO” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike.....	8610
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 89, datë 3.10.2014	Mbi miratimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjeve në kuadër të sigurimit të kredisë nga Banka Botërore për projektin për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike.....	8611
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 90, datë 6.10.2014	Mbi miratimin e transferimit të aksioneve të shoqërisë OSHEE sh.a. (njohur më parë si "CEZ shpërndarje" sh.a.), nga shoqëria CEZ a.s. te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	8612
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 91, datë 6.10.2014	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2015.....	8612
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 92, datë 6.10.2014	Për licensimin e shoqërisë “Sa’ga-Mat” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”, me fuqi totale 4.98 MW.....	8613
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 93, datë 6.10.2014	Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë Sa’Ga-mat” sh.p.k. nga HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4” me fuqi totale 4.98 MW.....	8613
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 94, datë 6.10.2014	Për licensimin e shoqërisë “Komp.energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”, me fuqi totale 4.21 MW.....	8614
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 95, datë 6. 10.2014	Për për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë Komp.Energji” sh.p.k. nga HEC-et Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” me fuqi totale 4.21 MW.....	8615



LIGJ
Nr. 137/2014

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK
PËR VITIN 2013

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet buxheti faktik për vitin 2013, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

Në milionë lekë

1. Buxheti i Shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	268 706
Shpenzimet, gjithsej	322 067
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
Të ardhurat	95 717
Shpenzimet	95 597
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
Të ardhurat	16 448
Shpenzimet	30 147
4. Deficiti buxhetor	- 66 940
5. Financimi i deficitit buxhetor	66 940
I brendshëm	56 129
A. Me instrumente financiare (kredimarrje e brendshme, neto)	46 298
1. Kredimarrje nga pushteti qendror	46 196
Bono thesari	- 4 586
Obligacione qeveritare 2/3/5/7/10-vjeçare	50 782
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	102
B. Të ardhura nga privatizimi	16 703
B.1. Pagesa e prapambetur e TVSH-së së rimbursueshme Kurum	- 3 473
C. Të tjera	- 3 399
Ndryshimi i gjendjes së arkës	- 9 618
Të tjera	6 219
Financimi i jashtëm (neto)	10 811.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8769, datë 4.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 138/2014

PËR KUJDESIN PALIATIV NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë të drejtën e qytetarëve për të përfituar kujdes paliativ, asistuar nga një ekip multidisciplinar, i cili është i orientuar drejt nevojave të pacientit dhe familjarëve të tij.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për shërbimin e kujdesit paliativ, mënyrën e ofrimit të tij, si dhe mënyrën e organizimit të shërbimeve shëndetësore e sociale që ofrojnë kujdes paliativ.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kujdes paliativ” është tërësia e ndërhyrjeve diagnostike, terapeutike dhe psikosociale, të orientuara si ndaj pacientit, ashtu edhe familjarëve të tij, kur sëmundja dhe pacienti, për shkak të evolucionit e prognozës së saj, nuk u përgjigjen më pozitivisht ndërhyrjeve të parashikuara në trajtimin e saj.



2. “Ekip multidisiplinar” është ekipi i përbërë nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, punonjës socialë, psikologë, fizioterapistë, terapistë okupacionalë, këshillues shpirtërorë, vullnetarë dhe specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ofrimin e shërbimit paliativ.

3. “Trajtim i dhimbjes” është një ndërhyrje multidisiplinare dhe shumëplanëshe, diagnostike dhe terapeutike, për të identifikuar e për të aplikuar trajtimet medikamentozë, kirurgjikale, psikologjike dhe rehabilituese të alternuara me njëra-tjetrën për ndërprerjen dhe kontrollin e dhimbjes.

4. “Pacient i kujdesit paliativ” është pacienti që është prekur nga një sëmundje kronike, e cila përparon, për të cilën nuk ekzistojnë terapi ose, nëse ekzistojnë, janë të pamjaftueshme për të stabilizuar sëmundjen.

5. “I sëmurë terminal” është personi, për të cilin trajtimi devijon nga qëllimi i shërimit në qëllim përkujdesjeje dhe lehtësimi. Pritshmëria e jetës së tij është mesatarisht 6 - 9 muaj.

6. “Kujdes terminal” është pjesa fundore e kujdesit paliativ, ku përshkruhet trajtimi i pacientëve gjatë periudhës kur fundi i jetës së pacientit është afër dhe atij i nevojitet shërbim intensiv.

7. “Hospis” është njësia e specializuar multidisiplinare e shërbimit të kujdesit paliativ, ku mund të ndërthuren ose të ofrohen të paktën një nga shërbimet: shërbimi në banesë, shërbimi me shtretër, shërbimi ditor. Këto shërbime mund të shoqërohen edhe me programe edukimi, trajnimi dhe/ose kërkimi në fushën e kujdesit paliativ.

8. “Terapi e dhimbjes” është tërësia e ndërhyrjeve diagnostike dhe terapeutike me qëllim për të gjetur terapi të përshtatshme farmakologjike, kirurgjikale, psikologjike, rehabilituese etj., me qëllim ndalimin dhe kontrollin e dhimbjes.

9. “Analgjëzikë opioidë” është grup medikamentesh psikoaktive, përgjegjëse për kontrollin e dhimbjes së moderuar në të fortë, sipas shkallës analgjëzike të rekomanduar nga OBSH-ja.

Neni 4

Parimet e ofrimit të kujdesit paliativ

Kujdesi paliativ ofrohet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- a) mbrojtja e dinjitetit dhe autonomisë së pacientit pa asnjë diskriminim;
- b) mbrojtja dhe promovimi i cilësisë së jetës deri në fund të saj;
- c) sigurimi i një jetese pa dhimbje deri në fund të saj;
- ç) mbështetja e duhur mjekësore e psikosociale për personin e sëmurë dhe familjen e tij;
- d) mosshpejtimi ose mosprovokimi i vdekjes.

Neni 5

Të drejtat e pacientëve në kujdes paliativ

Pacientët, gjatë marrjes së kujdesit paliativ, gëzojnë këto të drejta:

- a) marrjen e kujdesit paliativ të arritshëm dhe efikas;
- b) marrjen e informacionit për sëmundjen, prognozën dhe mënyrën e trajtimit;
- c) njohjen në mënyrë të përshtatshme me diagnozën dhe prognozën e vërtetë e të saktë të sëmundjes;
- ç) zgjedhjen e mënyrës e të llojit të trajtimit mjekësor ose kundërshtimin e tyre;
- d) ruajtjen e konfidencialitetit për gjendjen shëndetësore;
- dh) marrjen e vendimeve dhe dhënien e pëlqimit për trajtimin.

Neni 6

Përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë ka përgjegjësi për:

- a) hartimin e politikave shëndetësore për ofrimin dhe promovimin e shërbimeve të kujdesit paliativ, si dhe edukimin shëndetësor të profesionistëve shëndetësorë dhe publikut në fushën e kujdesit paliativ;
- b) hartimin e politikave shëndetësore dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, me qëllim ofrimin e shërbimit të kujdesit paliativ sa më pranë pacientit dhe familjarëve;



c) disponueshmërinë dhe aksesin në përdorimin e barnave esenciale për të sëmurët që ndodhen nën kujdes paliativ.

Neni 7

Informimi i publikut

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, në bashkëpunim me institucionet në varësi të saj, ndërmerr veprimet e nevojshme për informimin e publikut për:

- a) mënyrën e ofrimit të kujdesit paliativ;
- b) aksesin në kujdesin paliativ;
- c) të drejtat që gëzojnë përfutuesit e shërbimeve;
- ç) aksesin ndaj medikamenteve;
- d) llojshmërinë e shërbimeve të kujdesit paliativ në komunitet;
- dh) përfshirjen në programe të ndryshme në fushën e kujdesit paliativ.

KREU II

SHËRBIMET E KUJDESIT PALIATIV

Neni 8

Kategoritë e shërbimeve

1. Shërbimet shëndetësore, përmes të cilave ofrohet kujdes paliativ, janë:

- a) shërbimi në kujdesin shëndetësor parësor;
- b) hospis në banesë;
- c) hospis ditor;
- ç) hospis me shtretër;
- d) shërbime në institucionet spitalore;
- dh) shërbimi i kujdesit paliativ pediatrik;
- e) shërbimi vullnetar në nivel komuniteti.

2. Shërbimet e kujdesit paliativ ofrohen edhe nëpërmjet nismave private, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi, të organizatave jofitimprurëse, të familjarëve apo të palëve të treta. Në çdo rast, në këto nisma respektohen kriteret dhe normat e ofrimit të kujdesit paliativ dhe garantohej përdorimi etik e ligjor i të dhënave personale dhe konfidenciale.

3. Ngritja dhe mënyra e funksionimit të shërbimeve të kujdesit paliativ në institucionet publike të kujdesit shëndetësor përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 9

Kujdesi paliativ në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor

1. Kujdesi paliativ në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor është shërbimi që ofrohet nga mjekët e familjes, personeli infermieror ose personeli tjetër shëndetësor i specializuar në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor, qendrat shëndetësore dhe ambulancat, bazuar në paketën bazë të kujdesit shëndetësor parësor, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Kujdesi paliativ për këta pacientë kryhet nga personeli, mjekë dhe infermierë, në bazë të diagnozës së përcaktuar nga mjeku specialist. Në trajtimin dhe asistencën për pacientët përfshihet edhe shërbimi ndaj tyre në banesë.

Neni 10

Hospis në banesë

1. Hospis në banesë është shërbim i specializuar i kujdesit paliativ, që ofrohet nga një ekip multidisiplinar, qëllimi i të cilit është mbështetja për pacientin dhe familjen në banesë.

2. Shërbimi në banesë përfshin vizita të personelit multidisiplinar në banesën e të sëmurit për të arritur kontroll optimal të simptomave dhe gjithashtu mbështetje psikosociale apo/dhe shpirtërore për pacientin e familjen e tij.

3. Të gjitha vizitat, ndërhyrjet, procedurat, komunikimet, planifikimet dhe rishikimet e situatave të bëra nga një profesionist apo në grup kanë për qëllim rritjen e cilësisë së jetës së pacientit dhe mbështetjen për familjen përgjatë ecurisë së sëmundjes.

Neni 11

Hospis ditor

1. Hospis ditor është shërbim i specializuar i kujdesit paliativ, që ofrohet nga një ekip multidisiplinar në mjedis të posaçme për një pjesë të ditës, qëllimi i të cilit është trajtimi simptomatik, trajtimi i funksionalitetit, mbështetja psikosociale, socializimi i pacientëve, ndarja e përvojave ndërmjet tyre dhe mbështetje ndaj familjarëve të pacientëve.

2. Lëvizja e pacientëve nga banesa në hapësirën ose mjedisin e shërbimit bëhet e koordinuar, në orare të përcaktuara dhe me mjetet e këtij shërbimi.



Neni 12

Hospis me shtretër

1. Hospisi me shtretër, si pjesë e sistemit shëndetësor të integruar, është një shërbim i kujdesit paliativ me shtretër për të sëmurët në fazën terminale, të cilët, si rezultat i situatës kritike mjekësore dhe sociale, kanë nevojë për trajtim në këtë shërbim.

2. Kujdesi në hospis me shtretër ofrohet dhe në rastet kur pacienti terminal nuk ndodhet pranë fundit të jetës, por paraqiten situata kritike dhe të komplikuar, të cilat nuk përballohen në kushte shtëpie, sipas protokolleve klinike, por nevojitet kryerja e manipulimeve të ndryshme terapeutike, me qëllim përcaktimin e një terapie sa më efikase për kontrollin e dhimbjeve dhe simptomave të tjera.

3. Kujdesi në hospis me shtretër është 24 orë dhe ofrohet nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga mjekë, infermierë të kujdesit paliativ, punonjës socialë, psikologë, farmacistë, terapistë dhe vullnetarë.

Neni 13

Shërbimi në institucionet spitalore

1. Shërbimi i kujdesit paliativ në institucionet spitalore ofrohet nëpërmjet personelit të përbërë nga mjekë, infermierë dhe punonjës socialë, të specializuar për pacientët e shtruar në këto institucione.

2. Pranë çdo strukture spitalore në nivel rajonal ngrihet dhe funksionon shërbimi ndaj pacientëve, që kanë nevojë për kujdes paliativ me disa shtretër dhe personel shëndetësor që i asiston pacientët.

Neni 14

Shërbimi i kujdesit paliativ pediatrik

1. Kujdesi paliativ pediatrik shërben për trajtimin e fëmijëve me patologji të pashërueshme me qëllim:

a) garantimin e një cilësie më të mirë të jetës së fëmijës dhe familjarëve të tij, duke siguruar asistencë mjekësore, infermieristike, psikosociale e shpirtërore;

b) përcaktimin për çdo fëmijë të një programi të kujdesit paliativ për t'iu përgjigjur nevojave të tyre dhe familjes;

c) shmangien sa më shumë të jetë e mundur të shtrimit në institucionin spitalor për një periudhë të gjatë, duke promovuar ofrimin e kujdesit paliativ në shtëpi.

2. Rrjeti i shërbimeve shëndetësore, që trajton fëmijët me patologji të pashërueshme, shtrihet në të gjitha strukturat shëndetësore ku ofrohet kujdes paliativ për të rriturit, por në seksione të veçanta.

Neni 15

Shërbimi vullnetar në nivel komuniteti

1. Shërbimi vullnetar në nivel komuniteti bazohet në kontributin vullnetar të personave, të cilët ndihmojnë duke asistuar pacientët apo familjarët e tyre në shtëpi dhe hospis.

2. Pushteti vendor, brenda juridiksionit të tij, kontribuon për të organizuar dhe për të adresuar, sipas nevojave të familjeve të këtyre pacientëve, grupe vullnetarësh që asistojnë pacientët dhe familjet e tyre.

3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë mbështet nismat e organizatave jofitimprurëse që asistojnë me shërbime vullnetare pacientët dhe familjarët e tyre, si dhe të atyre organizatave që synojnë monitorimin e jashtëm e të pavarur të respektimit të të drejtave të njeriut në këtë sektor.

4. Veprimtaria e organizatave jofitimprurëse në fushën e kujdesit paliativ pranë mjediseve të institucioneve shëndetësore publike rregullohet në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë. Në çdo rast, gjatë kësaj veprimtarie, këto organizata respektojnë legjislacionin në fuqi për përdorimin etik dhe ligjor të të dhënave personale e konfidenciale.

Neni 16

Kujdesi paliativ në institucionet e ekzekutimit të vuajtjes së vendimeve penale

Personat, që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, përfitojnë kujdes paliativ, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe sipas kritereve e normave shëndetësore, të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.



KREU III MËNYRA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Neni 17

Shërbimet mjekësore

1. Në shërbimet mjekësore përfshihen pranimi, vlerësimi fillestar, vlerësimi mjekësor, plani i trajtimit, rivlerësimi dhe ndjekja në vazhdim, mbikëqyrja, komunikimi dhe edukimi i pacientëve e i familjarëve.

2. Shërbimet infermieristike ofrohen nga infermierë të kualifikuar në kujdesin paliativ që bashkëpunojnë në krijimin dhe zbatimin e planit të kujdesit.

3. Në aktivitetet infermieristike përfshihen:

- a) vlerësimi i pacientit;
- b) zbatimi i planit të trajtimit;
- c) vlerësimi i vazhdueshëm dhe përshtatja e planit të kujdesit;
- ç) komunikimi me pacientin, familjarët, kujdestarët dhe ekipin;
- d) mbikëqyrja e asistentëve vullnetarë;
- dh) edukimi i pacientëve, familjarëve dhe kujdestarëve;
- e) kujdesi i pacientit dhe familjes në kohën e vdekjes;
- ë) shërbime të tjera të nevojshme, sipas specifikës së pacientit.

Neni 18

Shërbimet sociale

1. Shërbimet sociale kryhen nga punonjësit socialë të kualifikuar që trajtojnë shqetësimet sociale e psikologjike të pacientëve, familjarëve dhe ofruesve të shërbimit, si para, ashtu dhe pas vdekjes së pacientit.

2. Në shërbimet sociale përfshihen:

- a) vlerësimi psikosocial;
- b) planifikimi i kujdesit;
- c) takime ndërdisiplinore;
- ç) këshillim;
- d) referime për shërbime dhe asistencë në procedura administrative;
- dh) edukim;
- e) mbrojtje e pacientit dhe familjes;
- ë) mbështetje psikosociale për familjet pas humbjes së të afërmit;
- f) pjesëmarrje në zgjedhjen dhe trajnimin e vullnetarëve;
- g) promovimin e kujdesit paliativ;

gj) mbikëqyrje dhe studime.

3. Në shërbimet sociale përfshihet dhe krijimi i rrjetit të vullnetarëve me punonjës socialë për ofrimin e asistencës në banesë.

Neni 19

Shërbime këshilluese dhe shpirtërore

1. Shërbimet këshilluese dhe shpirtërore ndihmojnë pacientët dhe familjet për të përballuar efektet e sëmundjes, vdekjen dhe dhimbjen.

2. Shërbimet këshilluese ofrohen nga psikologë, me qëllim vlerësimin psikologjik të gjendjes së pacientit dhe këshillimin e tij për të gjetur një mënyrë sa më efikase për t'u përballur me situatën ku ndodhet pacienti.

3. Mbështetja psikologjike e pacientit kryhet nëpërmjet mënyrave të ndryshme, si këshillim, meditim, dëgjim aktiv. Mbështetja psikologjike orientohet jo vetëm ndaj pacientit, por dhe ndaj familjarëve të tij për të ofruar mbështetje psikologjike gjatë sëmundjes së familjarit të tyre.

4. Kujdesi shpirtëror sigurohet nga një përfaqësues fetar ose dikush, i kualifikuar me arsimim ekuivalent dhe përfshin meditim, këshillim, lutje, apo praktika e rituale të shenjta, dëgjim aktiv dhe prezencë mbështetëse, pjesëmarrje në varrime, shërbime përkujtimore.

5. Këshillimi ofrohet në një nivel bazë nga secili anëtar i ekipit multidisiplinar. Për nevojën komplekse psikologjike, shërbimi sigurohet nga psikologë ose profesionistë të specializuar.

Neni 20

Shërbime vullnetare

1. Shërbimet vullnetare janë një pjesë e integruar e kujdesit paliativ. Ekipi i kujdesit paliativ përzgjedh vullnetarët, bazuar në aftësinë për të punuar si pjesë e ekipit, aftësinë e dëgjimit dhe komunikimit, ndjeshmërinë dhe sakrificën për njerëzit e sëmurë, konfidencialitetin, respektin për karakterin dhe qëndrimet personale të pacientit, si dhe integritetin moral.

2. Vullnetarët me përvojë personale të humbjes së të afërmyve të tyre nuk përfshihen në punë të drejtpërdrejta me pacientë ose familjet e tyre për një periudhë jo më pak se 2 vjet.

3. Vullnetarët, që punojnë në shërbimet e kujdesit paliativ, kanë nevojë për trajnim bazë dhe mbikëqyrje nga koordinatori vullnetar.



Aktiviteti i vullnetarëve është i bazuar në një kontratë të shkruar me ofruesin e shërbimeve të kujdesit paliativ.

Neni 21

Trajnimi i profesionistëve shëndetësorë

1. Të gjithë profesionistët shëndetësorë, pjesë e ekipeve multidisiplinare që ofrojnë kujdes paliativ, trajnohen për mënyrën e ofrimit të kujdesit paliativ.

2. Trajnimi i profesionistëve shëndetësorë kryhet nga ato institucione, programet e trajnimit për kujdesin paliativ të të cilave janë të akredituara nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim.

3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për arsimin ndërmarrin veprimet e nevojshme për hapjen e programit të studimit të formimit “Specializim afatshkurtër në kujdes paliativ”.

KREU IV AKSESI NDAJ BARNAVE

Neni 22

Lista e barnave esenciale

1. Të gjithë pacientëve që kanë nevojë për kujdes paliativ u garantohet aksesin në listën esenciale të barnave për kujdesin paliativ.

2. Barnat esenciale për kujdesin paliativ janë pjesë e listës së barnave të rimbursueshme dhe masa e mbulimit të tyre nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Përshkrimi i barnave të listës esenciale kryhet nga mjekët specialistë të kujdesit paliativ, mjekët onkologë dhe nga mjekët e familjes, të certifikuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, sipas rekomandimit të mjekut specialist në kujdesin paliativ ose mjekut onkolog.

4. Farmacitë janë të detyruara të disponojnë në çdo kohë barnat e listës esenciale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për barnat dhe barnat narkotike dhe psikotrope.

Neni 23

Aksesi te barnat “analgezikë opioidë”

1. Pacientët nën kujdes paliativ me dhimbje të moderuar deri në të fortë përfitojnë trajtimin me barna “analgezikë opioidë” në sasinë dhe për një

kohëzgjatje, sipas protokolleve të miratuara. Përshkrimi i barnave “analgezikë opioidë” bëhet për një periudhë deri në 28 ditë.

2. Barnat “analgezikë opioidë” përshkruhen nga mjekët specialistë të kujdesit paliativ, mjekët onkologë dhe nga mjekët e familjes, të certifikuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, sipas rekomandimit të mjekut specialist në kujdesin paliativ ose mjekut onkolog.

3. Mënyra e certifikimit të mjekëve të familjes nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë për përshkrimin e barnave “analgezikë opioidë” bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Për të gjitha rastet kur pacienti, për shkak të humbjes së jetës, nuk e përdor të gjithë sasinë e barnave “analgezikë opioidë”, familjarët ose përfaqësuesit ligjorë të tyre janë të detyruar që sasinë e mbetur ta depozitojnë pranë mjekut që ka përshkruar recetën për dhënien e barit “analgezik opioid”.

5. Mjeku përkatës mban një procesverbal për sasinë e barnave “analgezikë opioidë” që ka marrë në depozitim. Mënyra e përdorimit të kësaj sasive të mbetur të barnave “analgezikë opioidë” përcaktohet me udhëzim të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

KREU V FINANCIMI I KUJDESIT PALIATIV

Neni 24

Mbulimi nga skema e sigurimit shëndetësor

1. Personat, që kanë nevojë për kujdes paliativ, konsiderohen kategori ekonomikisht joaktive dhe kontributet për ta paguhen nga Buxheti i Shtetit.

2. Përcaktimi i personave, që kanë nevojë për kujdes paliativ, bëhet në nivel të çdo shërbimi nga një komision i përbërë nga tre punonjës të shërbimit shëndetësor, nga i cili trajtohet pacienti, të drejtuar nga drejtuesi klinik i shërbimit.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton kriteret e ngritjes së komisioneve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

4. Mënyra e përfitimit nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor rregullohet nga legjislacioni në fuqi për sigurimet shëndetësore.



Neni 25

Financimi i shërbimeve

1. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor kontraktton shërbimet e kujdesit paliativ, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të nenit 8, të këtij ligji, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shëndetësore.

2. Shërbimet publike të kujdesit paliativ, të përcaktuara në nenet 8, pika 1, e 16 të këtij ligji, financohen në investime nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

3. Shërbimet e kujdesit paliativ, që ofrohen nëpërmjet nismave private, organizatave jofitimprurëse, të familjarëve apo palëve të treta, mund të financohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, sipas marrëveshjeve të lidhura paraprakisht midis ministrisë dhe këtyre organizatave. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret e bashkëfinancimit të projekteve apo shërbimeve të kujdesit paliativ në rastin e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe organizatave jofitimprurëse.

Neni 26

Mbështetja sociale

Të sëmurët terminalë përfitojnë një pagesë, pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat e tjera që përfitojnë nga shteti. Masa e pagesës dhe kriteret për përfitim të kësaj pagese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Sanksione

1. Shkeljet e neneve të mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim administrativ kryesor si më poshtë:

a) Mospërspektimi i kriterëve dhe normave të kujdesit paliativ, të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, nga ofruesit e kujdesit paliativ, si publikë edhe privatë, dënohen me gjobë 50 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë 100 000 lekë.

b) Shkelja e pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji, mosofrimi i asistencës në banesë pacientëve që kanë nevojë për kujdes paliativ nga shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor, sipas paketës bazë të kujdesit shëndetësor parësor, dënohet me gjobë 20 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë 50 000 lekë.

c) Ofrimi i kujdesit paliativ nga vullnetarët pa kontratë me ofruesit e shërbimeve të kujdesit paliativ, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 3, të nenit 20, të këtij ligji, dënohet me gjobë 30 000 lekë.

ç) Mospërspektimi i barnave të listës esenciale, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 22, të këtij ligji, dënohet me gjobë 30 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë 50 000 lekë.

d) Shkelja e pikës 4, të nenit 22, të këtij ligji, dënohet me paralajmërim dhe shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për korrigjimin e shkeljes, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Në rast moszbatimi brenda afatit të urdhrit për korrigjimin e shkeljes, subjekti dënohet me gjobë 30 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë 50 000 lekë.

dh) Mospërspektimi i barnave “analgezike opioidë”, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 lekë.

2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e dënimeve të përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, është inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, ndërsa autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e dënimeve administrative, të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij neni, është inspektorati që mbulon fushën farmaceutike.

3. Kur konstatohet mospërdorimi etik dhe ligjor i të dhënave personale dhe konfidenciale të pacientëve, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 8, të këtij ligji, dhe në tërësinë e ligjit nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit paliativ, këta dënohen me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri 1 vit nga urdhri profesionist përkatës.

4. Inspektimi i kërkesave ligjore të përcaktuara në këtë ligj kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveç kur parashikohet ndryshe shprehimisht në këtë ligj.



5. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e shëndetit dhe inspektoratit që mbulon fushën farmaceutike bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin, ndërsa kundër vendimit të urdhrave profesionalë, sipas legjislacionit përkatës.

6. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

7. Të ardhurat e mbledhura nga gjობat, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 28

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 22, pika 2, 25, pika 3, dhe 26 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë, që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 3, 9, pika 1, dhe 16, 23, pika 3, dhe 24, pika 3, të këtij ligji.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8770, datë 4.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 139/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
HUAS DHE PROGRAMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, E FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT DHE KFW FRANKFURT AM
MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT
“FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8771, datë 4.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KfW Bankengruope, Postfach 111141,60046
Frankfurt am Main

Faks: (+355) 4 222 8494

Republika e Shqipërisë

Përfaqësuar nga

Ministria e Financave

Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

Tiranë

Shqipëri

Për dijëni

Faks: (+355)4 22 34885

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Rr. “Sami Frashëri”, nr. 10

Tiranë

Datë 20/12/2013

Sfera e Biznesit

KfW Entwicklungsbank

Stefan Krus

Our ref.: KSt

Tel.+49 69 7431 3674

Faks: +49 69 7431-2004

stefan.krus@kfw.de

Ndryshim i Marrëveshjes së Huas nr. 24916 për 20 milionë euro, ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të datës 23 dhjetor 2010-Fondi i Investimeve Sociale IV.



Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas prej 20 milionë euro (Marrëveshja e Huas), e cila është nënshkruar më 23 dhjetor 2010 ndërmjet KfW-së si Huadhënës dhe Republikës së Shqipërisë si Huamarrës, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Agjenci e Zbatimit të Projektit. Përveç kur shfaqet një synim i kundërt, termat me germa kapitale të përkufizuara në Marrëveshjen e Huas kanë të njëjtin kuptim në këtë letër.

Marrëveshja e Huas ndryshohet si më poshtë:

Neni 3.2 “Afati për kërkimin e disbursimit” zëvendësohet me sa më poshtë:

Të gjitha shifrat në euro	Disbursuar në periudhën përkatëse	Disbursuar në periudhat e mëparshme	Disbursimet e përgjithshme
01/01/13-30/06/13	628.000,00 euro	0	628.000,00 euro
01/07/13-31/12/13	1.020.000,00 euro	628.000,00 euro	1.648.000,00 euro
01/01/14-30/06/14	1.800.000,00 euro	1.648.000,00 euro	3.448.000,00 euro
01/07/14-31/12/14	2.900.000,00 euro	3.448.000,00 euro	6.348.000,00 euro
01/01/15-30/06/15	13.652.000,00 euro	6.348.000,00 euro	20.000.000,00 euro

*Shuma totale maksimale e akumuluar që mund të disbursohet deri në fund të secilës periudhë disbursimi

Duke nënshkruar këtë letër ndryshimi dhe duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese, Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Programit përsërisin përfaqësimin dhe deklaratimet e parashikuara në nenin 13.1 të Marrëveshjes së Huas.

Kjo letër nuk ndryshon asnjë dispozitë tjetër të Marrëveshjes së Huas dhe nuk përbën heqje dorë në lidhje me ndonjë prej të drejtave tona sipas Marrëveshjes së Huas.

Kjo letër rregullohet nga ligji gjerman.

Jeni të lutur të bëni të ditur pranimin tuaj për termat dhe kushtet e kësaj letre, duke e nënshkruar ku tregohet më poshtë dhe duke i kthyer një kopje origjinale KfW-së.

Me respekt

KfW

(firmë)

Andreas Rahe

(firmë)

Stefan Krus

Ne biem dakord për çështjet e parashikuara në letrën tuaj të datës 20 dhjetor 2013, ku kjo është kopje e saj.

Për dhe në emër të Ministrisë së Financave

Emri:

Titulli:

Për dhe në emër të Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Emri:

Titulli:

“KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30.6.2017.”.

Aneksi 1 “Grafiku i Disbursimit” zëvendësohet me sa më poshtë:

“Në fund të çdo periudhe të përcaktuar më poshtë, Huamarrësi ka kërkuar disbursimin e shumave të Huas që nuk kalojnë në total shumën e treguar më poshtë për çdo periudhë. Në masën që Agjencia e Zbatimit të Programit kërkon disbursime të shumave më të vogla brenda një periudhe gjashtëmujore, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në gjysmën e vitit pasues.”.

LIGJ

Nr. 140/2014

PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E AGRIKULTURËS PËR PROGRAMIN “MALET DREJT TREGUT”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Agrikulturës, për programin “Malet drejt tregut”.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8772, datë 4.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Faks nr. 00355 4 222 8494

Drejtuar: Shkëlqesisë së Tij
Shkëlqim Cani
Ministër i Financave i Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Tiranë, Shqipëri

Për dijëni: z. Nezir Haldeda
Zëvendësministër i Financave i Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Tiranë, Shqipëri
Faks nr. 00355 4 22558435

Nga: Khalida Bouzar
Drejtor
Divizioni i Lindjes së Afërme, Afrikës së Veriut dhe Europës
Departamenti i Menaxhimit të Programit
IFAD

Datë: 10 prill 2014

Lënda: Shqipëri: Programi “Malet drejt tregjeve” (Huaja MMP-IFAD Nr. 757-AL-Grant 1054-AL)

Kërkesë për shtyrjen e datës së mbylljes dhe rialokimin e fondeve

Z. Ministër

Referuar letrave tuaja të datës 13 shkurt dhe 2 prill 2014, kam kënaqësinë t’ju informoj se IFAD-i ka aprovuar, nga njëra anë, kërkesën tuaj për shtyrjen e përfundimit dhe datave të mbylljes së Huas për programin “Malet drejt tregjeve” (MMP) përkatësisht deri më 31 dhjetor 2014 dhe 30 qershor 2015, dhe nga ana tjetër, kërkesën tuaj për rialokimin e fondeve.

Meqenëse data e re e përfundimit të Programit është data e vitit në vazhdim, IFAD-i rekomandon që kategoria VIII-shuma e paalokuar (SDP 66, 928) duhet të alokohet plotësisht për të mënjeluar rialokime shtesë në një fazë të mëvonshme.

Bashkëlidhur do të gjeni grafikun e rishikuar 2 të Marrëveshjes së Financimit.

Pranoi, Shkëlqesi, sigurinë e konsideratës sime më të lartë.

Për dijëni: Bouzar Herlant
Lhommeau Dosje Projekti Regjistra
Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor:
Via Paolo di Dono, 44 00 142 Romë, Italy
Tel.+39 06 5491 Faks.+39 06 5043463
E-mail: ifad@ifad.org Faqe
interneti:www.ifad.org

Grafiku 2: Alokimi dhe tërheqja e shumave të Huas

Kategoria		Shuma e huas e alokuar (shprehur në SDR)	Shuma e grantit e alokuar e (shprehur në SDR)	% e shpenzimeve të lejueshme që duhet të financohen
I.	Punë civile	3 390 309		100% pa taksa dhe pa kontribute përfitimi
II.	Pajisje, mallra dhe mjete	120 000		100% pa taksa
III.	Asistencë teknike dhe studime a) Studime dhe sondazhe	330 000	30 000	100% pa taksa
IV.	Trajnim dhe seminare	56 928	130 000	100% pa taksa
V.	Grante a) Trajnim profesional b) Fermerët	129 568 1 376 419	100 000	100% pa taksa dhe pa kontribute përfitimi
VI.	Instrumenti i mbështetjes me kredi	176 776		100% pa taksa dhe pa kontribute përfitimi
VII.	Shpenzime periodike	280 000		30% (PYT) 70% (PY2)



				50% (PY3) 30% (PY4) 20% (PY5) 20% (më pas), pa taksa
VIII.	Të paalokuara	0		
Totali		5 860 000	260 000	

**VENDIM
Nr. 83/2014**

**PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË
PËRZGJEDHJES SË DY ANËTARËVE TË
KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 44 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet procedura paraprake e përzgjedhjes së dy anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, sipas fazave të mëposhtme:

a) Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën e organit kushtetues nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik). Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit për përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe pëlqimi i kandidatit me shkrim. Afati i dorëzimit të dokumentacionit të bëhet brenda 10 ditëve nga publikimi.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjësën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit, njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjësës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t’ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake e propozuar në pikën I, të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t’u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast që të paktën 28 deputetë t’i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miratuar në datën 30.10.2014

**VENDIM
Nr. 84/2014**

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT EDUARD YPI
ANËTAR I KOMISIONIT TË
AUTORITETIT TË KONKURENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Eduard Ypi emërohet anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miratuar në datën 30.10.2014



VENDIM
Nr. 85/2014

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS
PRANVERA STRAKOSHA
KOMISIONERE PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 12 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe në zbatim të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi prej jo më pak se 28 deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Pranvera Strakosha zgjidhet Komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miraturar në datën 30.10.2014

VENDIM
Nr. 86/2014

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ALBANA
SHTYLLA ANËTARE
E KËSHILLIT TË LARTË TË
DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 147, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi prej më shumë se 28 deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Albana Shtylla zgjidhet anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miraturar në datën 30.10.2014

VENDIM
Nr. 87/2014

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT VANGJEL
KOSTA ANËTAR I KËSHILLIT TË
LARTË TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 147, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi prej më shumë se 28 deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Vangjel Kosta zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miraturar në datën 30.10.2014

VENDIM
Nr. 88/2014

**PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR
EMËRIMIN E ZONJËS ELONA STAVRI
(TORO) ANËTARE E GJYKATËS SË
LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8683, datë 18 gusht 2014,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Elona Stavri (Toro) anëtare e Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miraturar në datën 30.10.2014



VENDIM
Nr. 89/2014

**PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR
EMËRIMIN E ZOTIT SOKOL NGRESI
ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8682, datë 18 gusht 2014,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Sokol Ngresi anëtar i Gjykatës së Lartë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miraturar në datën 30.10.2014

VENDIM
Nr. 91/2014

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT
PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E
LEGJSLACIONIT NË FUQI PËR
ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE,
SI DHE PËR TË NJOHUR DHE
VERIFIKUAR MË THELLË FENOMENIN
E NDËRHYRJES DHE TË BLOKIMIT
PËR DISA DITË TË SISTEMEVE
ELEKTRONIKE TATIMORE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e komisionit hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për

administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar më thellë fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore si më poshtë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1. _____ | kryetar (PD) |
| 2. Blendi Klosi | zëvendëskryetar (PS) |
| 3. Vasilika Hysi | anëtare (PS) |
| 4. Blerina Gjylameti | anëtare (PS) |
| 5. Ervin Koçi | anëtar (PS) |
| 6. Ervin Bushati | anëtar (PS) |
| 7. Përparim Spahiu | anëtar (LSI) |
| 8. _____ | anëtar (PD) |
| 9. _____ | anëtar (PD) |
| 10. _____ | anëtar (PD) |
| 11. _____ | anëtar (PD) |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miraturar në datën 30.10.2014

VENDIM
Nr. 92/2014

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT HETIMOR TË
KUVENDIT PËR VERIFIKIMIN E
LIGJSHMËRISË SË EMËRIMEVE NË
DETYRË NË ADMINISTRATËN
SHTETËRORE, ENTET PUBLIKE APO
SHOQËRITË TREGTARE
SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e komisionit hetimor për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore si më poshtë:



1. _____ kryetar (PD)
2. Taulant Balla zëvendëskryetar (PS)
3. Evis Kushi anëtare (PS)
4. Majlinda Bufi anëtare (PS)
5. Ulsi Manja anëtar (PS)
6. Bujar Derveni anëtar (LSI)
7. _____ anëtar (PD)
8. _____ anëtar (PD)
9. _____ anëtar (PD)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miraturar në datën 30.10.2014

VENDIM
Nr. 94/2014

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 10, pika 3, shkronja "ç", të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gentian Sala zgjidhet Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Illir Meta

Miraturar në datën 6.11.2014

DEKRET
Nr. 8766, datë 31.10.2014

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1198 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Irzeme Ramiz Mulliçi (Zeqiri)
2. Jana (Yana) Vladimir Mataj (Buldjajeva)
3. Idaver Shenasi Sherifi
4. Ukë Kolë Kolaj
5. Bajram Sadri Përteshi
6. Ralitsa (Ralica) Mihail Rizvanoli (Sapundxhieva)
7. Halil Hasan Demircan
8. Erim Hasan Çelik
9. Yunus Bilal Bayram
10. Pajtim Rrahman Mavriqi
11. Fatima Halil Eraslan
12. Harun Ömer Bostan
13. Ruba Numan Ahmad Albaroudi
14. Kujtim Avdullah Kastrati

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8768, datë 31.10.2014

**PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM TË
KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË,
PËR TË KRYER STAZHIN
PROFESIONAL SI GJYQTARË**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Matilda Sabah Fetau caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Zonja Esmerilda Agim Habili caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Zonja Ina Lulëzim Hoxhaj caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrehit Gjyqësor Tiranë.

Zonja Nertila Haxhi Kape caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrehit Gjyqësor Tiranë.

Zonja Armela Artur Hasantari caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrehit Gjyqësor Tiranë.

Zonja Yrfet Hasan Shkreli caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrehit Gjyqësor Tiranë.

Zoti Paulin Nazif Çera caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrehit Gjyqësor Tiranë.

Zoti Besmir Hito Stroka caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrehit Gjyqësor Tiranë.

Zoti Gentian Luigj Marku caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrehit Gjyqësor Lezhë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 86, datë 29.9.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EFT
ALBANIA” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 2; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EFTAlbania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe

Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.

(Mungon akti i themelimit të shoqërisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” (e paplotësuar)

(Mungon sasia e energjisë elektrike që parashikohet të tregtohet për pesë vitet e ardhshme.)

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” (e paplotësuar)

Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c” (e paplotësuar)

Mungon lista e kontratave të mëparshme të realizuara (nëse ka patur).

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 87, datë 29.9.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EFT
ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9; 13 pika 1 germa “ç”; 45 pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f”, 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EFT Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht (Mungon akti i themelimit të shoqërisë.).

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike

- Neni 9, pika 4/9, germa “a”

(Mungon sasia e energjisë elektrike që parashikohet të tregtohet për pesë vitet e ardhshme.)

- Neni 9, pika 4/9, germa “b”

(Mungon niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar.)

- Neni 9, pika 4/9, germa “c”

Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 88, datë 29.9.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “UKKO”
SHA NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
IMPIANTE FOTOVOLTAIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e



paraqitur nga shoqëria “UKKO” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “UKKO” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.4.1 pika 4.4.2; 4.4.3) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.4.4) është plotësuar pjesërisht: Mungon plani i biznesit.

- Leje nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.4.5) është plotësuar pjesërisht: Mungon leja mjedisore nga organet përkatëse.

- Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “UKKO” sh.a., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiantet fotovoltaike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 89, datë 3.10.2014

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJEVE NË
KUADËR TË SIGURIMIT TË KREDISË
NGA BANKA BOTËRORE PËR
PROJEKTIN PËR RIMËKËMBJEN E
SEKTORIT TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (të ndryshuar), vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 10.1.2013, “Për miratimin e rregullores mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij” (të ndryshuar), Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 3.10.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për dhënie autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjeve në kuadër të sigurimit të kredisë nga Banka Botërore për projektin për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike,

konstatoi se:

Për finalizimin e procedurave për sigurimin e kredisë prej 150 000 000 (150 milionë) dollarësh ndërmjet Bankës Botërore dhe palëve të sektorit të energjisë elektrike nevojitet nënshkrimi e marrëveshjes së huas, dhe marrëveshjeve përkatëse, për projekte specifike. Për këtë duhet që administratori i shoqërisë OSHEE sh.a. të ketë të gjitha kompetencat për ndjekjen e procedurave të nevojshme për nënshkrimin e marrëveshjes së huas, si dhe marrëveshjeve të tjera në funksion të projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. T’i japë autorizimin e posaçëm z. Arben Seferaj për nënshkrimin e marrëveshjeve në kuadër të sigurimit të kredisë nga Banka Botërore për projektin për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të personat e interesuar lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 90, datë 6.10.2014

**MBI MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË
AKSIONEVE TË SHOQËRISË OSHEE
SHA (NJOHUR MË PARË SI CEZ
SHPËRNDARJE SHA), NGA SHOQËRIA
CEZ AS TE MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aneksit 2 të ligjit nr. 114/2014, datë 31.7.2014 “Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s”, pas shkresës nr. 4189/4, datë 15.9.2014 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga ana e Drejtorisë Juridike,

- duke konsideruar se:

Shoqëria “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (OSHEE sh.a.), njohur më parë si “CEZ Shpërndarje”, sh.a., është privatizuar me anë të ligjit nr. 10116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe ÇEZ a.s.-së”;

- Me ligjin nr. 114/2014, datë 31.7.2014 është miratuar Marrëveshja e zgjidhjes me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s.

- Në bazë të aneksit 2 të kësaj Marrëveshjeje, aksionet e shoqërisë OSHEE sh.a. (njohur më parë si “CEZ Shpërndarje” sh.a., të cilat janë në pronësi të shoqërisë CEZ a.s., do t'i kalojnë shtetit shqiptar, pasi ndërmjet të tjerave, ERE të nxjerrë një vendim që miraton transferimin e aksioneve nëpërmjet Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve,

VENDOSI:

1. Miratimin e transferimit të aksioneve të shoqërisë OSHEE sh.a. (njohur më parë si CEZ

Shpërndarje sh.a.), nga shoqëria CEZ a.s. te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe shoqërinë OSHEE sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 91, datë 6.10.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR OST SHA
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 59, datë 29.12.2005, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2015, si dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2015.



2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 92, datë 6.10.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“SA’GA-MAT” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGIJË
ELEKTRIKE NGA HEC-ET “GERMAN
1”, “GERMAN 2”, “GERMAN 3” DHE
“GERMAN 4”, ME FUQI TOTALE
4.98 MW**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pikat 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4” me fuqi totale 4.98 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në: nenin 9, pikat 1 (formatin e aplikimit); nenin 9, pikat 2 (dokumentacionin juridik, administrator dhe pronësor); nenin 9, pikat 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës të përcaktuara në: nenin 9, pika 4.1.1 (Të dhëna specifike për HEC); neni 9, pika 4.1.2 (Të

dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (Dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (Dokumentacioni tekniko- ekonomik); neni 9, pika 4.1.5.

(Leje nga institucione të tjera) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “German 1” me fuqi 1,2 MW, “German 2” me fuqi 1,68 MW, “German 3” me fuqi 1,29 MW dhe “German 4” me fuqi 0,81, me fuqi totale 4.98 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 93, datë 6.10.2014

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES TË SHOQËRISË SA’GA-
MAT” SHPK NGA HEC-ET “GERMAN
1”, “GERMAN 2”, “GERMAN 3” DHE
“GERMAN 4”, ME FUQI TOTALE
4.98 MW**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “I”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “P”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”; nenit 9 pika 1 dhe pika 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”, me fuqi totale 4.98 MW,



konstatohet se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. është plotësuar konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga HEC-et “German 1” me fuqi 1,2 MW, “German 2” me fuqi 1,68 MW, “German 3” me fuqi 1,29 MW dhe “German 4” me fuqi 0,81, me fuqi totale 4.98 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 94, datë 6.10.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KOMP. ENERGJI” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET
“HURDHAS 1”, “HURDHAS 2” DHE
“HURDHAS 3”, ME FUQI TOTALE
4.21 MW**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pikat 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë
Faqe | 8614

22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”; 5 pika 1 germa “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Komp.Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga Hec-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”,

konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Komp.Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në: nenin 9, pika 1 (formatin e aplikimit); nenin 9, pika 2 (dokumentacionin juridik, administrator dhe pronësor); nenin 9, pika 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës të përcaktuara në: nenin 9, pika 4.1.1 (Të dhëna specifike për HEC); neni 9, pika 4.1.2 (Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (Dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (Dokumentacioni tekniko- ekonomik); neni 9, pika 4.1.5.

(Leje nga institucione të tjera) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Komp.Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike HEC-et “Hurdhas 1” me fuqi 1,71 MW, “Hurdhas 2” me fuqi 1,3 MW dhe “Hurdhas 3” me fuqi 1,2 MW, me fuqi totale 4.21 MW për një afat 30- vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 95, datë 6.10.2014

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES TË SHOQËRISË
KOMP.ENERGJI” SHPK NGA HEC-ET
HURDHAS 1”, “HURDHAS 2” DHE
“HURDHAS 3”, ME FUQI TOTALE
4.21 MW**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “P”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”; nenit 9 pika 1 dhe pika 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp. Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC-et Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” me fuqi totale 4.21 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Komp.Energji” sh.p.k., është plotësuar konform “Rregullave dhe procedurave të certifi-

kimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Komp.Energji” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga HEC-et “Hurdhas 1” me fuqi 1,71 MW, “Hurdhas 2” me fuqi 1,3 MW dhe “Hurdhas 3” me fuqi 1,2 MW, me fuqi totale 4.21 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 24 lekë